VENDIM
Nr. 27/1, datë 5.11.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:
Vitore Tusha kryetare;
Elsa Toska anëtare;
Marsida Xhaferllari anëtare;
Fiona Papajorgji anëtare;
Altin Binaj anëtar;;
Sonila Bejtja anëtare;
Përparim Kalo anëtar,
në datën 5.11.2021, mori në shqyrtim në seancë mbi bazë dokumentesh çështjen që u përket:
KËRKUESE: Partia Republikane e Shqipërisë, përfaqësuar me autorizim nga z. Dardan Mustafaj avokat.
Partia Agrare Ambientaliste, në mungesë.
Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, në mungesë.
Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, në mungesë.
Partia Demokristiane e Shqipërisë, në mungesë.
SUBJEKTE TË INTERESUARA:
Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar me autorizim nga znj. Mimoza Arbi.
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar me autorizim nga znj. Madalena Koja.
OBJEKTI: Saktësim në vendimin nr. 27, datë 29.6.2021 të Gjykatës Kushtetuese.
BAZA LIGJORE: Neni 80 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

e iniciuar kryesisht, pasi dëgjoi relatorin e çështjes Përparim Kalo shqyrtoi dhe diskutoi çështjen në tërësi:

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Partia Republikane, Partia Agrare Ambientaliste, Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, Partia Demokristiane e Shqipërisë *(kërkueset)* në datën 12.2.2021 i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata),* duke kërkuar shfuqizimin e fjalisë së dytë të paragrafit të tretë të nenit 88, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 118/2020)* me përmbajtjen: *"Për partitë pjesëtare në koalicion, numri i votave të vlefshme takuese përllogaritet duke mbledhur mesataren e votave për mandat për çdo kandidat të zgjedhur nga radhët e tyre."*.
2. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 27, datë 29.6.2021, ka vendosur: *"Rrëzimin e kërkesës"*.
3. Pas publikimit të vendimit, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar mungesën e pjesëzës mohuese ***"nuk"*** në fjalinë e fundit të paragrafin 40 të vendimit, konkretisht:
*"40 ... Po kjo gjykatë, në një rast tjetër ka vlerësuar se ligjvënësi është i lirë të vendosë për mënyrën e financimit të partive politike, kandidatët e të cilave kanë fituar bindshëm në zgjedhjet përkatëse por, nga ana tjetër, ka vlerësuar se ai (**nuk** - pjesëza që mungon) duhet të vendosë kushte që ushtrojnë ndikim negativ në*

zhvillimin e lirë të sistemit pluralist ose rëndojnë në mënyrë shpërpjesëtimore mbi partitë politike që nuk përmbushin kushtet për marrjen e fondeve nga buxheti i shtetit (vendim i datës 29 mars 2012 i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë)".

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Saktësimin e vendimit nr. 27, datë 29.6.2021, të Gjykatës Kushtetuese, duke shtuar në fjalinë e fundit të paragrafit nr. 40 pjesëzën mohuese të munguar ***"nuk"***. Pas këtij saktësimi, fjalia e fundit e paragrafit nr. 40 lexohet si vijon:

"Po kjo gjykatë, në një rast tjetër ka vlerësuar se ligjvënësi është i lirë të vendosë për mënyrën e financimit të partive politike, kandidatët e të cilave kanë fituar bindshëm në zgjedhjet përkatëse por, nga ana tjetër, ka vlerësuar se ai ***nuk*** *duhet të vendosë kushte që ushtrojnë ndikim negativ në zhvillimin e lirë të sistemit pluralist ose rëndojnë në mënyrë shpërpjesëtimore mbi partitë politike që nuk përmbushin kushtet për marrjen e fondeve nga buxheti i shtetit (vendim i datës 29 mars 2012 i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë).*

2. Një kopje e këtij vendimi i bashkohet vendimit nr. 27, datë 29.6.2021, të Gjykatës Kushtetuese.

3. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 5.11.2021.
Shpallur më 15.12.2021.

Kryetare: Vitore Tusha
Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Përparim Kalo, Sonila Bejtja